



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 12.09.2019

RAPORT PËR

“RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS EVROPIANE TË INVESTIMEVE, PËR PROJEKTIN “SHTRATI I LUMIT LANA – ZHVILLIM URBAN””

Hyrje

Të nderuar anëtarë/e të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

Në bazë të Kalendarit të Punimeve të Kuvendit dhe të kalendarit të punës së Komisionit, jam caktuar relator për projektligjin “Për Ratifikimin E Marrëveshjes së Grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “shtrati I Lumit Lana – Zhvillim Urban””, për të cilin Komisioni ynë është komision për dhënie mendimi.

Komisioni e shqyrton këtë projektligj në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Nëpërmjet këtij projektligji synohet ratifikimi i marrëveshjes së grantit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane të Investimeve, për projektin “Shtrati i lumit Lana – zhvillimi urban”, në shumën prej 2,4 milionë eurosh.

Vlera e grantit në shumën 2,4 milionë euro do të shërbejë për bashkëfinancimin e projektit “Shtrati i lumit Lana – zhvillim urban”, për të cilin BEI-ja akordon edhe një kredi në shumën 8 milionë euro. Nuk parashikohen shpenzime nga buxheti i shtetit. Nisur nga plani i veprimt

dhe i implementimit të këtij projekti, vlera, e cila do të mbulohet nga shpenzimet buxhetore të Bashkisë Tiranë, do të jetë e shpërndarë në 3 vite buxhetore, duke nisur nga viti buxhetor aktual. Kjo vlerë plotëson vlerën e grantit dhe të kredisë, me qëllim implementimin e projektit.

Përmes këtij projekti mundësohet krijimi i një shtrati me regjim hidraulik eficient, për të eliminuar problematikën e përmbytjeve në këtë zonë, si dhe duke krijuar hapësirat e nevojshme të zhvillimit urban të zonës.

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen Bashkia Tiranë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

III. ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

1. Në Komision u diskutua nëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndonjë të dhënë mbi kostot totale të parashikuara të projektit duke qënë se marrëveshja parashikon që efektet financiare të mbulohet nga shpenzimet buxhetore të Bashkisë Tiranë, e shpërndarë në 3 vite buxhetore duke nisur që nga viti buxhetor aktual. Përfaqësuesit e Bashkisë Tiranë konfirmuan se këto kosto janë reflektuar në projektbuxhetin afatmesëm (PBA).

IV. PËRFUNDIM

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Së fundi, si relator vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji dhe u kërkoj kolegëve ta miratojmë atë në Komision.

RELATORE

AURORA MARA

KRYETAR

ULSI MANJA